

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pikat 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2654/1 datë 23.06.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3137/2 datë 29.07.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 6-të mbajtur më 29.07.2025, miratoi sa vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, për shkeljen e kryer të nenit 51, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 3 qershor 2025, nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve.

Shkelja e përmendur në paragrafin 1 të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2654/1, datë 23.06.2025, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

2. URDHËROHET që SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia, në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të veprimtarisë së botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të veprimtarisë së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, LSHMAAV dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele duhet t'u ofrojnë shfrytëzuesve të tyre qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershëm të të dhënave në vijim: emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual, përkatësisht emrin, shenjën mbrojtëse ose shenjën e shkurtuar të identifikimit (avizo, logo, etj.); adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual; të dhënat për kontakt me ofruesin e shërbimit mediatik audio ose audiovizual (numri i telefonit, e-mail adresa dhe/ose faqja e internetit, personi i kontaktit për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe nëse është e mundur, dhe trupit rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia, përmes Sektorit për çështje programore, më 18 qershor 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, të transmetuar më 3 qershor 2025, në nivel lokal, gjatë së cilës u konstatua shkelje e nenit 51, paragrafi (1) të LSHMAAV.

Konkretisht, nga mbikëqyrja u konstatua se më 3 qershor 2025, SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve, përkatësisht nuk u ka lejuar atyre qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku për të dhënat e mëposhtme: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual; adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik

audiovizual; të dhënat për kontakt (numri i telefonit, e-mail adresa dhe/ose faqja e internetit; personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe të trupit rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2654/1 datë 23.06.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TRD TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë më 07.07.2025, ka dërguar Shkresë ark.nr.10-2654/2 datë 07.07.2025, me të cilën dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2654/1 datë 23.06.2025, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoj deklaram me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 09.07.2025. Në afatin e parashikuar SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 29.07.2025, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, t'i shqiptohet masë – paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pikat 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2654/1 datë 23.06.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3137/2 datë 29.07.2025, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 29.07.2025, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në përputhje me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2654/1 datë 23.06.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

Mr. Sasho STEFANOVSK

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.